

ÇËSHTJA E
PERSONAVE TË ZHVENDOSUR NË
KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE
NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com

STUDIM *MBI*:
ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR NË
KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’
EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE
SERBISË

Shtator 2019

STUDIM MBI:
ÇËSH TJEN E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR NË
KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’ EVENTUALE
NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Shtator 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrja dhe Konteksti	1
Problemet me të cilat përballen personat e zhvendosur në Kosovë dhe aktivitetet e institucioneve në adresimin e kësaj çështje.....	3
Roli i nismave rajonale dhe forumeve në adresimin e çështjes së personave të zhvendosur	12
Pozicioni i Kosovës lidhur me çështjen e personave të zhvendosur në procesin negociator të dialogut.....	14
Përfundimet	15
Rekomandime	18

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
CCTV	Televizion me qark të mbyllur (Kamera Mbikqyrëse)
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KFOR	Forcat e Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAE	Roma, Ashkali dhe Egjiptas
UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Hyrja dhe Konteksti

1. Lufta në Kosovë përfundoi më 10 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës e cila siguroi protektoratin ndërkombëtar të Kosovës. Sipas mandatit të Kombeve të Bashkuara, Forcat e Kosovës (KFOR) hynë në Kosovë dy ditë më vonë, më 12 qershor. KFOR-it ju besua vendosja e paqes në Kosovë dhe krijimi i një mjedisi të sigurt për të gjitha minoritetet dhe komunitetin në tërësi.¹ Konflikti që u zhvillua në Kosovë gjatë vitit 1999, por edhe episodet e mëvonshme të dhunës (mars 2004) që rezultuan me trazira në mbarë Kosovën, shkaktuan zhvendosje masive të të gjitha etnive të Kosovës brenda dhe jashtë vendit. Gjatë luftës 1.2 deri 1.45 milion shqiptarë të Kosovës u zhvendosën nga Kosova.² Ndërsa pas luftës, përderisa forcat serbe të sigurisë po tërhiqeshin nga Kosova dhe KFOR-i po futej në Kosovë, shqiptarët e Kosovës po ktheheshin nga vendet fqinje, kurse rreth 200,000 serbë dhe pakica të tjera etnike joshqiptare u larguan nga Kosova.³
2. Sipas UNHCR, që nga viti 2017 numri i personave të zhvendosur që presin zgjidhjen e statusit të zhvendosjes së tyre mbetet i lartë, me rreth 90,000 individë të zhvendosur.⁴ Numri i të zhvendosurve nga Kosova në Serbi është më i larti me rreth 72,000, 16,486 janë të zhvendosur brenda Kosovës, ndërsa 879 dhe 610 janë zhvendosur në Mal të Zi dhe Maqedoninë Veriore respektivisht. Bazuar në të njëjtin burim, deri në vitin 2016, numri i kthimeve vullnetare është 27,286 persona në dhe brenda Kosovës. Numri i personave të kthyer ka qenë vazhdimisht në rënie që nga viti 2011, kurse numri më i ulët që nga viti 2000, është regjistruar në vitin 2018 me vetëm 327 persona të kthyer.⁵

¹ UNHCR dhe Praxis (2007), 'Analiza e Situatës së Personave të Zhvendosur nga Kosova në Serbi: Ligji dhe Praktika'. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/4704bff72.html> [Qasur më: 1 gusht 2019]

² Qendra e Monitorimit të Zhvendosjes së Brendshme (IDMC) (2018), 'Raporti Global për Zhvendosjen e Brendshme për Kosovën', dhjetor 2018. Në dispozicion në: <http://www.internal-displacement.org/sites/default/files/2018-05/GRID%202018%20-%20Figure%20Analysis%20-%20KOSOVO.pdf> [Qasur më: 4 gusht 2019]

³ Po aty.

⁴ UNHCR (2017), 'Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - një rivlerësim i interesimit për t'u kthyer'. Në dispozicion në: <https://www.unhcr.org/see/10873-displaced-people-from-kosovo-in-the-region-a-re-assessment-of-interest-to-return.html> [Qasur më: 10 gusht 2019]

⁵ UNHCR (2019), 'Shenim faktdhënës Kosova*'. Në dispozicion në: <https://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2019/04/Fact-sheet-Kosovo-4-April-2019.pdf> [Qasur më: 10 gusht 2019]

3. Numri më i lartë i personave të zhvendosur brenda vendit është në rajonin e Mitrovicës. Një vlerësim nga UNHCR konstaton se 6,939 shqiptarë janë zhvendosur në Mitrovicën e Jugut. Numri i serbëve të zhvendosur nga ky rajon është 6,859 (gjegjësisht Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan), të cilët kryesisht janë zhvendosur në komunën e Graçanicës dhe fshatrat përreth me shumicë serbe.⁶
4. Menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, midis janari të vitit 2000 dhe majit të vitit 2001, filloi një konflikt midis Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) dhe policisë serbe në Luginën e Preshevës. UÇPMB kërkonte të bashkohej me Kosovën pasi që rreth 80% e këtij rajoni është i banuar nga shqiptarët. Shqiptarët lokalë kishin frikë nga policia serbe për shkak të krimeve që ata kishin kryer në Kosovë dhe si pasojë, 15,000 shqiptarë nga ky rajon u zhvendosën në Kosovë. Pas përfundimit të konfliktit, me marrëveshjen e paqes në maj të vitit 2001, rreth 5,500 persona të zhvendosur u kthyen në luginë, në Serbinë Jugore.⁷
5. Kthimi i personave të zhvendosur është një proces kompleks, sepse përfshin një numër të madh faktorësh që ndikojnë në të. Faktorë të tillë mund të jenë siguria dhe liria e lëvizjes, lehtësimi i marrjes së dokumenteve personale, ndërtimi dhe rindërtimi i shtëpive të të zhvendosurve, qasja në arsim në gjuhë amtare të të kthyerve, qasja në shërbimet shëndetësore dhe gjithashtu mundësitë e punësimit. Korniza ligjore e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të drejtat ndërkombëtare sigurojnë që komunitetet të mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës në Kosovë. Puna e vazhdueshme e *Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Këshillit Konsultativ për Komunitete, Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe gjithashtu organizatave ndërkombëtare* ka siguruar që kthimi i të zhvendosurve të mund të arrihet duke krijuar kushte të qëndrueshme për kthimin dhe integrimin e të kthyerve.

⁶ Po aty.

⁷ Global IDP (2005), 'Profili i Zhvendosjes së Brendshme: Serbia & Mali i Zi'. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/4051dda14.html> [Qasur më: 13 gusht 2019]


6. Ky studim ofron një analizë të faktorëve që ndikojnë në zhvendosjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës. Po ashtu, shpërfaq angazhimin e institucioneve kosovare dhe ndërkombëtare në adresimin e kësaj çështjeje, buxhetin e shpenzuar në projektet për personat e zhvendosur nga donatorët e brendshëm dhe ndërkombëtarë, si dhe pozicionin e Kosovës në lidhje me këtë çështje në procesin negociator të dialogut.

Problemet me të cilat përballen personat e zhvendosur në Kosovë dhe aktivitetet e institucioneve në adresimin e kësaj çështjeje

7. Shumë faktorë që lidhen me kushtet e jetesës, integrimin social dhe ekonomik të të kthyerve përcaktojnë vendimin e tyre për t'u kthyer. Më konkretisht, këta faktorë përfshijnë disponueshmërinë e shërbimeve publike, mundësitë për gjenerimin e të ardhurave, qasjen në të drejtat pronësore, strehimin dhe infrastrukturën, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes si dhe marrëdhëniet ndëretnike. Disponueshmëria e fondeve gjithashtu përcakton dinamikën e kthimit, ngase numri i të kthyerve varet pothuajse drejtpërdrejt nga qasja e tyre në këto fonde. Këta faktorë janë diskutuar më gjerësisht në pjesën e mëposhtme.
8. Analiza e situatës aktuale të personave të zhvendosur u plotësua me një sërë intervistash në terren. Të intervistuarit janë përzgjedhur në bazë të pozitës së tyre aktuale në institucionet lokale dhe ndërkombëtare në lidhje me çështjen e personave të zhvendosur brenda Kosovës dhe në vendet fqinje.
9. Të intervistuarit janë:
 - I intervistuari 1, Zyrtar i lartë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
 - I intervistuari 2, Përfaqësues i UNHCR-së
 - I intervistuari 3, Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Minoriteteve dhe Kthimit
 - I intervistuari 4, Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Minoriteteve dhe Kthimit
 - I intervistuari 5, Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Minoriteteve dhe Kthimit

10. Ka pasur një sërë aktivitete dhe projektet të zbatuara nga Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit dhe organizatat ndërkombëtare të cilat janë të përkushtuara për të adresuar çështjen e zhvendosjes dhe për të rritur numrin e të kthyerve. Kjo rezultoi në një numër të madh të kthimeve vullnetare në Kosovë. Sipas një raporti të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, numri i të kthyerve është rritur pas pavarësisë së Kosovës. Megjithatë, shifrat tregojnë se numri i të kthyerve ka filluar të bjerë pas vitit 2010.⁸

Tabela 1. Të kthyerit gjatë periudhës 2000-2018



Burimi: UNHCR (2018) Statistikat e kthimit 2013 – 2018

11. Një faktor përcaktues në procesin e vendimmarrjes për kthimet vullnetare është siguria dhe liria e lëvizjes. Ekziston një perceptim i mungesës së sigurisë në Kosovë, i cili bazohet në situatën politike në veri të Kosovës, përkatësisht në rajonin e Mitrovicës. Bazuar në një hulumtim të udhëhequr nga UNHCR dhe në një raport të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në përgjithësi, personat e zhvendosur janë të sigurt të kthehen në shumicën e lokacioneve në Kosovë. Sidoqoftë, ende ka vende të caktuara brenda komunave të Kosovës ku banorët kanë shfaqur rezistencë në raste kur personat e zhvendosur kanë vizituar këto vende me synim që të kthehen.⁹

⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës (2013), 'Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014 – 2018'. Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf [Qasur më: 10 gusht 2019]

⁹ UNHCR (2017), 'Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - një rivlerësim i interesimit për t'u kthyer', UNHCR Zyra Rajonale në Evropën Juglindore, 2017. Në dispozicion në:

- 12.** Një raport i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim identifikoi se çështjet e sigurisë janë më të lidhura me lokacionet në veri të Mitrovicës, ku ka pasur uzurpim të pronave të komuniteteve të ndryshme.¹⁰ Megjithatë, siguria dhe liria e lëvizjes janë të drejta themelore të njeriut; prandaj, një përmirësim i këtyre faktorëve do të siguronte kthimin individëve të zhvendosur që shprehin interesim për t'u kthyer.
- 13.** Është kuptuar se ekziston një klimë paqësore në Kosovë dhe një vullnet social dhe fizik për të pranuar të zhvendosurit të cilët janë të interesuar të kthehen në Kosovë. Ka pasur një përpjekje të jashtëzakonshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje. Të gjithë të intervistuarit theksuan rëndësinë e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes për të kthyerit dhe se është thelbësore të rritet numri i të kthyerve.
- 14.** Për të gjithë të zhvendosurit, një nga nevojat më themelore është mbështetja në rindërtimin e plotë të shtëpive të tyre. Kushtet e strehimit në mesin e popullsisë së zhvendosur dallojnë. Në Serbi, 63% e të zhvendosurve jetojnë në kushte të mira ose të shkëlqyera, ndërsa 37% në kushte të këqija ose kushte shumë të këqija. Në Malin e Zi, 10% jetojnë në kushte të mira, ndërsa 90% jetojnë në kushte të këqija ose shumë të këqija. Ekzistojnë marrëveshje të ndryshme për pronat, disa posedojnë prona, kurse të tjerët i marrin ato me qira. Katërqind e gjashtëdhjetë e pesë (465) familje të cilat posedojnë prona nuk do të jenë prioritet për ndihmën e strehimit, pavarësisht se kanë shprehur interesim për t'u kthyer.¹¹
- 15.** Kushte të këqija të banimit raportohen veçanërisht në mesin e të zhvendosurve në Mal të Zi. Kjo edhe më tutje e konfirmon nevojën për zgjidhje të menjëhershme për kthimin e këtyre të zhvendosurve nga Mali i Zi, Maqedonia dhe familjet e cenuara të zhvendosura në Serbi. Në total 1003 familje kanë nevojë për ndërtimin/riparimin e banesave. Shtatëqind e dyzetë e tre (743) familje të

<https://www.unhcr.org/see/10873-displaced-people-from-kosovo-in-the-region-a-re-assessment-of-interest-to-return.html> [Qasur më: 5 gusht 2019]

¹⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës (2013), 'Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014 – 2018', dhjetor 2013. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf)

[ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf) [Qasur më: 7 gusht 2019]

¹¹ Shih fusnotën 7

zhvendosura në Serbi raportohet se kanë nevojë për ndihmë për strehim në mënyrë që të kthehen.¹²

16. Deri në vitin 2013 ka pasur nisma të konsiderueshme që trajtuan çështjen e kushteve të banimit. Një raport i prezantuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, dëshmon se 972 shtëpi janë ndërtuar midis periudhës 2009 dhe 2013.¹³ Megjithatë, vetëm 67% e këtyre shtëpive u banuan në këtë periudhë. Duke pasur parasysh se kushtet e strehimit po trajtohen nga projekte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare dhe atyre të Kosovës, ndërkaq numri i të kthyerve mbetet i ulët, kjo mund të sugjerojë se *ekziston një mungesë vullneti mes të zhvendosurve që të kthehen në vendin e tyre të origjinës.*

Tabela 2. Statusi i shtëpive të ndërtuara dhe të banuara¹⁴

YEAR OF CONSTRUCTION	2009	2010	2011	2012	2013	Totali
Total houses built	229	238	265	247	120	972
Total residential houses	118	134	191	203	90	651
Percentage of homes currently inhabited	52%	56%	72%	91%	75%	67%

17. Kjo teori mbështetet edhe nga të intervistuarit të cilët gjithashtu e kanë theksuar këtë problem. Siç dëshmohet më lartë, institucionet e Kosovës kanë krijuar mekanizma, kanë ndarë fonde të mëdha dhe kanë ndërtuar shtëpi që sot nuk janë të banuara. Ekziston një bindje e përgjithshme se këto shtëpi janë pranuar ligjërisht nga personat e zhvendosur, por më vonë janë shitur ose braktisur. Ka dëshmi se institucionet e Kosovës kanë bërë përpjekje të mjaftueshme që personat e zhvendosur të kthehen; megjithatë, dyshohet se disa pakica mund të jenë *manipuluar* për të mos u kthyer në Kosovë.

¹² Shih fusnotën 7

¹³ Qeveria e Republikës së Kosovës (2013), 'Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014 – 2018'. Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf [Qasur më: 10 gusht 2019]

¹⁴ Po aty.

18. Aktualisht, ka disa projekte nga organizatat ndërkombëtare që vazhdojnë të mbështesin kthimin e të zhvendosurve në ndërtimin e shtëpive, por gjithashtu edhe në adresimin e çështjeve të tjera për një kthim të qëndrueshëm. Një projekt i udhëhequr nga UNHCR do të mbështesë 579 familje të zhvendosura jashtë dhe brenda Kosovës në kthim të qëndrueshëm. Faza e katërt e Kthimit dhe Riintegrimit në Kosovë e financuar nga BE, u mundësoi 30 familjeve që të arrijnë kthim dhe integrim të qëndrueshëm në vitin 2017, ndërkaq faza e pestë e këtij projekti synon që të ndihmojë rikthimin e 400 familjeve deri në vitin 2020.¹⁵ Megjithatë, duke marrë parasysh numrin e lartë të të zhvendosurve brenda dhe jashtë Kosovës, *më shumë fonde duhet të adresohen nga BE-ja për këtë çështje.*

19. Qeveria e Kosovës ka ndarë një buxhet të konsiderueshëm Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2009-2013. Përveç kësaj, kjo ministri ka përforcuar bashkëpunimin e saj me partnerët ndërkombëtarë si Zyra e BE-së në Kosovë, Ambasada e Britanisë së Madhe dhe USAID, ndër të tjera, për të siguruar fonde shtesë për zbatimin e projekteve në funksion të kthimit dhe integrimin të komuniteteve.¹⁶ Tabela më poshtë paraqet fondet për periudhën e sipërpërmendur. Siç është paraqitur në tabelën mëposhtme, vetëm në vitin 2013, më shumë se 7 milionë euro janë menaxhuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive, rritjen e sigurisë për kthimin e të zhvendosurve, përmirësimin e jetesës së tyre etj. Në vitet e mëparshme shuma e ndarë për këtë çështje ka qenë edhe më e lartë.

¹⁵ UNHCR (2017), 'Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - një rivlerësim i interesimit për t'u kthyer'. Në dispozicion në: <https://www.unhcr.org/see/10873-displaced-people-from-kosovo-in-the-region-a-re-assessment-of-interest-to-return.html> [Qasur më: 19 gusht 2019]

¹⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës (2013), 'Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014 - 2018'. Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf [Qasur më: 12 gusht 2019]

Tabela 3. Alokimi i fondeve për procesin e kthimit ¹⁷

	2009	2010	2011	2012	2013
MCR	8,707,057.00€	8,652,046.00€	7,160,317.00€	7,179,045.00€	7,179,045.00€
EU	EU support to Mitrovica Initiative Roma, Ashkali and Egyptian communities The EU-MRSI - Closing the camp Qesmin Lug and Osterode February 2010 - December 2012 EU: € 5 million, MCR: € 0.1 million				2013-2015 Return of Roma, Ashkali and Egyptians EU: 1.8 mil; MCR: 0.2 mil
EU - RRK	RRK I: - june 2008 - Oct. 2010 EU: 3.3 mil; MCR 1.1 mil; UNDP: 0.4 mil	RRK II: Aug. 2009 - July 2011; EU: 4 mil €; MCR 1.1 mil €; DRC: 0.2 mil €	RRK III: 1 Nov. 2011 - Apr. 2014; EU: 4 mil; MCR € 1.1 mil; IOM € 0.2 mil)		
EU Community Stabilization		CSP I: 2010 - 2012 EU: 2 mil €; MCR: 0.1 mil. €	CSP II: 2012 - ongoing EU 3 mil; MCR 1 mil		
US State Department BPRM	<u>2009-2010</u> 849,985.00 \$ 528,646.00 \$	<u>2010-2011</u> 467,999.00 \$	<u>2011-2013</u> 400,567.00 \$	<u>2012- 2013</u> 477,000.00 \$ 700,000.00\$	<u>2013-2014</u> 396,028.00 \$
British Embassy	2009-2010: 164,127 €	2010-2011: 353,000 €	2011-2012: 511,330 €	2012-2013: 563,922 €	2013-2014: 214,372€

20. Pavarësisht buxhetit të lartë të dedikuar për kthimin e personave të zhvendosur, numri i të kthyerve nuk është aq i lartë krahasuar me fondet e ndara. Nga intervistat e kryera është dëshmuar se ekziston vullneti institucional për të zgjidhur këtë çështje, megjithatë, të zhvendosurit nuk duhet të manipulohen nga strukturat paralele.

21. Sa i përket rolit të institucioneve ndërkombëtare (UNHCR, OSBE etj.) në trajtimin e çështjes së të zhvendosurve, u argumentua, se pa mbështetjen e tyre kthimi dhe integrimi do të ishin procese shumë më të vështira. Është evidentuar se UNHCR koordinon aktivitetet me institucionet e tjera ndërkombëtare si UNMIK, Zyra e BE-së në Kosovë, OES, IOM, e kështu me radhë. Ky institucion monitoron rregullisht riintegrimin e qëndrueshëm dhe siguron mbrojtjen e minoriteteve, të kthyerve

¹⁷ Po aty.

vullnetar dhe të personave të zhvendosur brenda vendit. Më tutje, UNHCR fillimisht vendos koordinimin me institucionet e Kosovës dhe pastaj me aktorët ndërkombëtarë për të mbështetur një zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur, e veçanërisht për ata që gjenden në qendrat kolektive.

- 22.**Roli vendimtar i këtyre institucioneve është theksuar, mirëpo ekziston një perceptim i përgjithshëm se institucionet ndërkombëtare duhet të jenë edhe më aktive në zgjidhjen e kësaj çështje. Argumenti kryesor është se të zhvendosurit mund t'i besojnë më shumë organizatave ndërkombëtare, andaj ato duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të rritur numrin e të kthyerve në Kosovë.
- 23.**Ekziston gjithashtu një besim i ndryshëm midis zyrtarëve të ministrisë që organizatat ndërkombëtare duhet të kenë vetëm një rol ndërmjetësues dhe lehtësues pasi që sipas tyre, institucionet e Kosovës duhet të kryejnë aktivitetet kryesore lidhur me çështjen e zhvendosjes. Institucionet ndërkombëtare duhet të ofrojnë mbështetje teknike ose këshillime bazuar në përvojën e tyre dhe gjithashtu të sigurojnë fonde nëse është e nevojshme për strehimin, sigurinë, sigurimin e ndihmës ligjore e kështu me radhë.
- 24.**Qasja në dokumente personale - Mungesa e dokumentacionit personal pa të cilin të zhvendosurit kanë vështirësi në qasjen e të drejtave të tjera civile duket të jetë një faktor, mirëpo jo një përcaktues që pengon procesin e kthimit. Posedimi i certifikatës së lindjes apo ndonjë dokumenti tjetër identiteti nuk është një nga problemet kryesore për serbët, por duket se është një problem më relevant për komunitetin RAE.
- 25.**Bazuar në një hulumtim të kryer nga UNHCR dhe UNDP, një pjesë e madhe e komunitetit RAE nuk posedojnë të paktën një nga dokumentet personale të identifikimit, kartat e sigurimit shëndetësor, dokumentet e pronësisë dhe broshurat e regjistrimit të punësimit.¹⁸ Komuniteti serb, nga ana tjetër, ka më

¹⁸ UNHCR dhe UNDP (2009), 'PZHBV-të nga dhe brenda Kosovës: Rreziqet dhe Burimet', qershor 2009. Në dispozicion në: <https://drc.ngo/media/1659347/idps-from-and-within-kosovo.pdf> [Qasur më: 20 gusht 2019].

shumë mundësi që të mos posedojë diploma arsimore, broshura për regjistrimin e punësimit dhe në raste më të rralla certifikata të lindjes dhe letërnjoftimin personal. Sipas UNHCR-së, një numër i caktuar i komunitetit RAE nuk kanë ndonjë dokument personal për të provuar vendin e tyre të lindjes ose të prindërve.¹⁹ Megjithatë, ka një përpjekje të konsiderueshme të UNHCR dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për të përmirësuar situatën dhe për të siguruar që institucionet përgjegjëse të adresojnë mungesën e dokumenteve të regjistrimit në mesin e popullatës së zhvendosur. *Ata kanë ofruar ndihmë juridike dhe kanë ndjekur qasje pragmatike për personat e zhvendosur dhe regjistrimin e tyre.*

26. Me qëllim të përshpejtimit të qasjes në dokumentacionin e të zhvendosurve, fillimisht duhet të ketë një regjistër të saktë të personave të zhvendosur, me detajet e tyre personale, informacionin rreth rrethanave dhe arsyeve të zhvendosjes së tyre, dhe gjithashtu nëse kanë interes të kthehen në Kosovë. Për sa i përket menaxhimit të kthimit të personave të zhvendosur, ky informacion do të kishte qenë vendimtar.

27. Gjithashtu, është argumentuar se vonesa e marrjes së shtetësisë dhe dokumenteve personale të identifikimit mund të sjellë probleme të tjera potenciale; të kthyerit mund të angazhohen në aktivitete kriminale në Kosovë dhe identifikimi i personit pa dokumente personale nuk do të jetë i mundur. *Për të adresuar këto çështje, UNHCR ka raportuar se ky regjistër ka filluar të krijohet në vitin 2018 përmes dialogut të programit "Procesi i Shkupit" (i përshkruar më hollësisht në seksionin e ardhshëm) dhe informatat rreth personave të zhvendosur janë duke u mbledhur.*

28. Kosova ka Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Diasporës dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, por gjithashtu edhe instrumente të tjera të mjaftueshme për të trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejt këtë çështje. Andaj, kjo çështje nuk duhet të varet tërësisht nga palët e treta që qëllimisht e vendosin veten midis institucioneve dhe personave të zhvendosur për të ndjekur kështu interesat

¹⁹ UNHCR (2017), 'Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - një rivlerësim i interesimit për t'u kthyer', UNHCR Zyra Rajonale në Evropën Juglindore, 2017. Në dispozicion në: <https://www.unhcr.org/see/10873-displaced-people-from-kosovo-in-the-region-a-re-assessment-of-interest-to-return.html> [Qasur më: 2 gusht 2019]

e tyre. Institucionet e Kosovës duhet të zhvillojnë marrëdhënie më të ngushta me qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë etnike ose vendin ku ata jetojnë.

29. Sipas UNHCR-së, 361 persona të zhvendosur deklarohen të jenë analfabetë, ndër të cilët 50 janë fëmijë.²⁰ Bazuar në studimin e UNHCR, qasja në arsim është një problem pasues i shkaktuar nga mungesa e dokumentacionit. 26% e komunitetit RAE nuk mund të kenë qasje në arsim për shkak të mungesës së dokumentacionit personal. Ky studim gjithashtu gjeti prova të një pabarazie të dallueshme mes komunitetit serb dhe RAE në vijimin e shkollës. Kjo pabarazi rritet me rritjen e nivelit të arsimit ku komuniteti RAE është pothuajse tërësisht i përjashtuar nga arsimi universitar.²¹ Qasja në arsim është një e drejtë themelore e njeriut dhe si e tillë kërkon vëmendje të menjëhershme; *autoritetet duhet të sigurojnë shkathtësi efektive dhe regjistrim në shkolla dhe gjithashtu qasje në arsim cilësor për të gjithë të zhvendosurit dhe të kthyerit. Kjo duhet të jetë pjesë integrale e aktiviteteve në mbështetje të kthimit dhe riintegrit.*

30. UNHCR raportoi se në mesin e personave që janë intervistuar për hulumtimin e tyre, gjithsej 9% e të zhvendosurve vuajnë nga gjendja shëndetësore dhe një përqindje e caktuar i përkasin grupeve të ndjeshme të shoqërisë si, prindër të vetëm, të moshuar në rrezik, gra apo fëmijë në rrezik.²² Ka disa nevoja specifike të paplotësuara në lidhje me kujdesin mjekësor për komunitetin serb dhe komunitetin RAE. Për të trajtuar çështjen e personave të zhvendosur me nevoja të veçanta dhe për të siguruar përfshirjen efektive dhe prioritizimin e këtyre kategorive, kriteri i ndjeshmërisë së këtyre kategorive duhet të zbatohet në mënyrë efektive gjatë procesit të kthimit të përfituesve.

31. Jetesa - Një nga nevojat më urgjente në mënyrë që personat e zhvendosur të kthehen janë mundësitë për gjenerimin e të ardhurave. Ky është një parakusht për integrimin e qëndrueshëm ekonomik të të kthyerve. *Ka pasur një shumë të*

²⁰ Po aty.

²¹ UNHCR dhe UNDP (2009), 'PZHBV-të nga dhe brenda Kosovës: Rreziqet dhe Burimet', qershor 2009. Në dispozicion në: <https://drc.ngo/media/1659347/idps-from-and-within-kosovo.pdf> [Qasur më: 13 gusht 2019]

²² Shih fusnotën 16

*konsiderueshme të granteve të dedikuara për mundësitë e gjenerimit të të ardhurave, si p.sh. grante që mbështesin krijimin e bizneseve të vogla dhe programet e ndërmarrësisë të cilat pritet të nxisin ekonominë lokale në një periudhë afatgjatë. Ka pasur gjithashtu një sërë projektesh të tjera për punësim të të kthyerve, siç janë trajnimet e përgjithshme, këshillimi në qendrat e punës, trajnimet në vendin e punës, subvencionimi i punësimit me punëdhënësin privat etj.*²³²⁴²⁵

32. Programet aktive të tregut të punës në përpjekje për të integruar ekonomikisht të kthyerit nuk arriti të transformohet në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kjo erdhi si pasojë e rritjes së ulët ekonomike dhe shkallës së lartë të papunësisë në mesin e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Ka pasur shumë raste kur të zhvendosurit janë kthyer në Kosovë, por nuk kanë arritur të integrohen ekonomikisht, kështu që janë detyruar të kthehen përsëri në vendin e tyre të zhvendosjes. Nga bisedat me të intervistuarit, është kuptuar se ky fenomen më së shumti ka ndodhur tek komuniteti egjiptas, kurse serbët në anën tjetër, nuk kanë qenë të interesuar të kthehen, me gjasa për arsye politike. Shkalla e papunësisë në Kosovë në vitin 2018 ka qenë rreth 30%²⁶, andaj, për të krijuar mundësi më të mira punësimi, *duhet të financohen më shumë programe të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë dedikuar për të kthyerit.*

Roli i nismave rajonale dhe forumeve në adresimin e çështjes së personave të zhvendosur

33. "Procesi i Shkupit" ka qenë një iniciativë rajonale e filluar në vitin 2014 nga OSBE dhe UNHCR dhe e mbështetur nga Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, për të

²³ Corbanese, V., & Rosas, G. (2007). 'Tranzicioni i të rinjve në punë të mirë: Dëshmi nga Kosova'. Në dispozicion në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---emp_policy/documents/publication/wcms_113895.pdf [Qasur më: 11 gusht 2019]

²⁴ UNHCR dhe UNDP (2009), 'PZHBV-të nga dhe brenda Kosovës: Rreziqet dhe Burimet'. Në dispozicion në: <https://drc.ngo/media/1659347/idps-from-and-within-kosovo.pdf> [Qasur më: 3 gusht 2019]

²⁵ UNDP (2010), 'Projekti rajonal për Shoqatat e PZHBVs Faza II Parandalimi i shpërnguljeve të mëtejshme dhe Rimëkëmbja e pjesës së Personave të Zhvendosur në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi'. Në dispozicion në: https://www.undp.org/content/dam/undp/documents/projects/KOS/00046721_UNDP_Kosovo_Final_Project_Review_Report.pdf [Qasur më: 1 gusht 2019]

²⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019), 'Anketa e Fuqisë Punëtore'. Në dispozicion në: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-afp-2018> [Qasur më: 13 gusht 2019]

nisur një proces rajonal të përkushtuar në gjetjen e një zgjidhjeje për kthimin dhe integrimin social dhe ekonomik të të zhvendosurve në Kosovë. Institucionet relevante nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica takohen rregullisht në baza vjetore dhe angazhohen për të trajtuar çështjen e personave të zhvendosur dhe për të ofruar zgjidhje. *Institucioni kryesor i këtij procesi në Kosovën është Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, promovimin dhe zbatimin e legjislacionit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të të kthyerve.*

34. Vendimi i "Procesit të Shkupit" përfshin rritjen e anëtarëve të komuniteteve në Policinë e Kosovës, përderisa OSBE organizonte fushata për të informuar dhe inkurajuar komunitetet për të aplikuar në këtë institucion. Një projekt tjetër i miratuar nga kjo iniciativë është rritja e CCTV-ve në fshatrat me numrin më të madh të të kthyerve. Po ashtu, është identifikuar nevoja për 40,000 euro shtesë për këtë çështje. Kjo iniciativë, gjithashtu, ka vendosur që personat e zhvendosur të jenë të përjashtuar nga pagesa e tatimit të akumuluar gjatë periudhës kur ata nuk kanë qenë duke banuar në pronat e tyre.²⁷

35. Në 2017, u krijua një fond kompensimi prej 300,000 euro për rindërtimin e shtëpive, ndërsa në vitin 2018 edhe 300,000 euro të tjera u ndanë për këtë çështje. Një grup punues ligjor i themeluar nga qeveria është në procesin e hartimit të një udhëzimi administrativ për të udhëhequr këtë proces.²⁸

36. Sa i përket lëshimit të dokumentacionit personal; regjistrimi i gjendjes civile, lëshimi i letërnjoftimeve dhe dokumentet e udhëtimit janë plotësisht të përfshira në normat ligjore. Pra, janë në dispozicion për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Çështjet e qasjes më të lehtë për shërbimet dhe aplikimin me zyrat e gjendjes civile do të përfundohen me udhëzimet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

²⁷ Ministria për Komunitete dhe Kthim (2018), 'Nisma ndër-institucionale për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova'. Në dispozicion në: <http://mzp-rks.org/en/images/dokumenta/ENG-Leaflet-SopjeProcess.pdf> [Qasur më: 2 gusht 2019]

²⁸ Po aty.

37. Gjithashtu, ka pasur një iniciativë për të krijuar një bazë të dhënash me informacionin e nevojshëm për personat e zhvendosur të cilën do ta menaxhojë Ministria për Komunitete dhe Kthim. Derisa ky projekt të përfundojë, UNHCR do të vazhdojë të udhëheqë shkëmbimin e të dhënave në mes të institucioneve përkatëse dhe të mbështesë ministrinë në këtë drejtim.

38. Janë realizuar edhe disa aktivitete dhe programe të udhëhequra nga Rrjeti i Dialogut Nansen: Programi i kthimit në Fushë Kosovë / Kosovo Polje, Programi i Mitrovicës dhe Programi i Komunës së Obiliqit. Që nga viti 2010, këto programe kanë ndihmuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, kanë ofruar mbështetje për institucionalizimin e bashkëpunimit të rregullt ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, kanë motivuar banorët e këtyre komunave (sidomos të Mitrovicës) të mos largohen dhe kanë forcuar integrimin e komuniteteve në sistemin arsimor si dhe kurset mësimore (për gjuhën angleze, teknologjinë e informacionit etj.). Këto programe rriten bashkëpunimin midis profesionistëve të arsimit, studentëve dhe prindërve të etnive të ndryshme.

39. Rrjeti i Dialogut Nansen ndihmoi në rritjen e motivimit të komunitetit serb në lidhje me pjesëmarrjen në dialogun ndëretnik në Kosovë, si një parakusht vendimtar për pajtim. Për më tepër, përmes këtyre programeve, rrjeti i dialogut Nansen rriti besimin mes minoriteteve dhe komuniteteve shumicë në Kosovë.

Pozicioni i Kosovës lidhur me çështjen e personave të zhvendosur në procesin negociator të dialogut

40. Kthimi i personave të zhvendosur është e drejtë themelore e njeriut për të gjitha komunitetet, andaj institucionet e Kosovës janë plotësisht të angazhuara për të arritur të gjitha objektivat për kthimin e tyre. Çështja e të zhvendosurve është e rëndësishme në dialogun Kosovë-Serbi, edhe pse nuk është çështje kryesore e dialogut. Është theksuar se marrëveshjet e nivelit të lartë duhet të përfshijnë këtë problem pasi kjo do të mbështeste zgjidhjen e qëndrueshme të të zhvendosurve.

- 41.** Ka çështje teknike në lidhje me kthimin e të zhvendosurve që jo domosdoshmërisht duhet të politizohen dhe diskutohen në këtë dialog, siç janë regjistrimi qytetar, posedimi i dokumenteve personale dhe lehtësimi i procesit për marrjen e shtetësisë apo kombësisë. Këto çështje kanë nevojë për menaxhim të mirë sesa diskutim të nivelit të lartë në dialogun Kosovë-Serbi.
- 42.** Një çështje e rëndësishme për kthim theksohet të jetë siguria e të kthyerve në shtëpitë e tyre, e cila është një nevojë themelore për një jetë normale. Siç u argumentua më lartë, shumica e vendeve në Kosovë tashmë janë të sigurta për kthim. Megjithatë, problemi mbetet në vende të caktuara siç është Mitrovica e Veriut, kështu që kjo çështje duhet të diskutohet në detaje në dialogun Kosovë-Serbi. Çështja e të zhvendosurve është aktive në forumin "Procesi i Shkupit" ku të gjitha vendet me interes për të zhvendosurit, Kosova, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia Veriore janë përfshirë në diskutim. Në këtë projekt, zgjidhjet më të preferuara për kthimin dhe integrimin e të zhvendosurve konsiderohen dhe diskutohen me të gjitha vendet e përfshira.
- 43.** Kosova duhet t'i bëjë kërkesa specifike Serbisë në lidhje me çështjen e personave të zhvendosur: të mos politizojë problemin, të mos e pengojnë kthimin, të mos manipulojnë të zhvendosurit dhe të zbatojë fondet e dedikuara për të zhvendosurit me përgjegjësi të plotë.

Përfundimet

- 44.** Ky studim vë në pah punën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në adresimin e çështjes së personave të zhvendosur në Kosovë dhe në vendet fqinje. Siç u theksua, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka ndarë më shumë se 7 milion euro në vitin 2013 për çështjen e personave të zhvendosur (raportet për vitet e fundit nuk janë të disponueshme). Një sasi e konsiderueshme fondesh janë ndarë gjithashtu nga organizatat ndërkombëtare dhe donatorët si BE, Ambasada Britanike dhe Departamenti i Shtetit Amerikan.

- 45.** Ekzistojnë disa projekte nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur. UNHCR udhëheq një projekt që synon të mbështesë 579 familje të zhvendosura jashtë dhe brenda Kosovës në kthim të qëndrueshëm në vendndodhjen e tyre të origjinës. BE gjithashtu udhëheq një projekt të vazhdueshëm për Kthimin dhe Riintegrimin e të zhvendosurve në Kosovë, që u mundësoi 30 familjeve të integrohen në vendin e tyre të kthimit në 2017, ndërsa faza tjetër siguron që 400 familje të arrijnë kthim të qëndrueshëm deri në vitin 2020.
- 46.** Projekti "Procesi i Shkupit", i cili është iniciuar dhe mbështetur nga UNHCR dhe OSBE, është i angazhuar në gjetjen e një zgjidhjeje për kthimin dhe integrimin e të zhvendosurve në Kosovë. Institucioni kryesor i këtij projekti është Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, e cila është gjithashtu përgjegjëse për krijimin e politikave, promovimin dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. "Procesi i Shkupit" ka ndarë 300,000 euro në 2017 dhe 300,000 euro të tjera në 2018 për t'i ndihmuar personat e zhvendosur në kthimin e tyre.
- 47.** Përveç kësaj, ky projekt ka promovuar aplikimin e komuniteteve në Policinë e Kosovës dhe ka organizuar fushata informative për t'i inkurajuar ata që të aplikojnë. Gjithashtu, kjo iniciativë vendosi që personat e zhvendosur duhet të përjashtohen nga pagesa e tatimit të akumuluar gjatë periudhës që ata nuk banonin në pronat e tyre. Ka pasur gjithashtu një nismë për të mbledhur një fond prej 40,000 euro për të rritur CCTV-të në fshatrat me numrin më të madh të të kthyerve.
- 48.** Programet e përfunduara nga Rrjeti i Dialogut Nansen i cili u përqendrua në tri komuna kryesore të kthimit në Fushë Kosovë, Mitrovicë dhe Obiliq, kanë rritur dialogun ndëretnik, kanë bërë rritjen e bashkëpunimit mes tyre dhe nxitjen e tyre që të mos largoheshin nga këto komuna (veçanërisht nga Mitrovica).
- 49.** Një tjetër qëllim i rëndësishëm i kësaj iniciative ishte sigurimi se komunitetet janë të integruara mirë në sistemin arsimor. Në përpjekje për të rritur bashkëpunimin ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve të etnive të ndryshme, ky program

gjithashtu krijoi një bibliotekë multietnike dhe kurse të të mësuarit (për gjuhën angleze, teknologjinë e informacionit etj.). Duke pasur parasysh se është parakushti vendimtar për pajtimin në Kosovë dhe në vendet fqinje, ky program ka forcuar dialogun mes komuniteteve të ndryshme, në mënyrë specifike, atë të komunitetit serb me komunitetet e tjera, nëpërmjet ndërtimit të besimit mes tyre.

50. Institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare kanë qenë të përkushtuara në përmirësimin e strehimit dhe kushteve e jetesës së të kthyerve. Deri në vitin 2013, janë ndërtuar 972 shtëpi për të kthyerit. Megjithatë, është raportuar se vetëm 651 nga numri i përgjithshëm i shtëpive të ndërtuara kanë qenë të banuara gjatë periudhës 2009-2013. Ekziston një bindje e përgjithshme se shtëpitë janë fituar ligjërisht nga personat e zhvendosur, por pastaj ata janë larguan, ndërsa shtëpitë janë shitur ose braktisur.

51. Siç dëshmohet më lart, një shumë e madhe fondesh dhe një numër projektesh janë dedikuar drejt adresimit të kësaj çështje nga institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Sidoqoftë, një numër i shtëpive të ndërtuara për këtë qëllim nuk janë të banuara. Kjo siguron dëshmi të forta që sugjerojnë se ose *ka mungesë vullneti* të të zhvendosurve që të kthehen në vendin e origjinës ose mund të jenë *manipuluar* në mos kthimin nga një palë e tretë. Ekziston gjithashtu një perceptim i përgjithshëm se kjo çështje është politizuar qëllimisht, gjë që është kontradiktore duke pasur parasysh vullnetin e lartë institucional nga Kosova për kthimin e personave të zhvendosur.

52. Siç raportohet nga UNHCR-ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, në përgjithësi ka një ambient të sigurisë dhe lirisë së lëvizjes për të gjitha komunitetet dhe ky nuk është shqetësim për shumicën e vendbanimeve të dëshiruara për kthim në Kosovë. Ka vetëm pak vende brenda disa komunave të cilat kanë siguri më të ulët që mund të ndikojnë në kthimin e të zhvendosurve, siç është rasti në Mitrovicën e Veriut.

53. Ministria për Komunitete dhe Kthim së bashku me organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare janë të përkushtuara në përmirësimin e kushteve të sigurisë në

këto vende, duke qenë se kjo është një e drejtë themelore e njeriut. Megjithatë, ende ekziston shqetësimi për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes në komunën e Mitrovicës, prandaj nuk ka shumë raste të kthimit në këtë komunë.

54. Vetëm 47 persona të zhvendosur brenda vendit u kthyen në Mitrovicë në vitin 2018, derisa asnjë i zhvendosur nuk u kthye nga vendet fqinje. Numri i të kthyerve për periudhën 2000-2018 është më ulët në Mitrovicë me vetëm 3222 persona, krahasuar me komunitat e tjera (numri më i madh është në komunën e Prishtinës me 8352 persona).

55. Numri i personave të zhvendosur nga Lugina e Preshevës arriti në 15,000 në periudhën midis janarit 2000 dhe majit 2001, pas shpërthimit të një konflikti midis UÇPMB dhe policisë serbe. Si pasojë rreth 15,000 shqiptarë nga ky rajon ikën në Kosovë duke kërkuar siguri. Pas përfundimit të konfliktit me marrëveshjen e paqes në maj të vitit 2001, rreth 5,500 persona të zhvendosur u kthyen në luginë në Serbinë Jugore.²⁹ Numri i të shpërngulurve ndryshon gjatë viteve në varësi të tensioneve në rajon dhe rritjes së mundësive të punësimit në Kosovë, krahasuar me Luginën e Preshevës.³⁰ Nuk ka të dhëna zyrtare se sa mund të jetë numri i të zhvendosurve në periudhat e mëvonshme.

Rekomandime

56. Çështja e personave të zhvendosur duhet të përfshihet në dialogun Kosovë-Serbi, duke pasur parasysh se ende ka një numër të zhvendosurish që nuk kanë vullnet të kthehen. Duhet të bëhet e qartë gjatë dialogut se kjo çështje duhet të mbështetet nga qeveria serbe dhe personat e zhvendosur nuk duhet të manipulohen për arsye politike.

²⁹ Global IDP (2005), 'Profile of Internal Displacement: Serbia & Montenegro'. Geneva, Switzerland.

³⁰ Po aty.

57. Prandaj, duhet të bëhet një hulumtim se cilët janë faktorët që ndikojnë në mosgatishmërinë e tyre për t'u kthyer, dhe pse numri i të kthyerve u rrit vetëm pas pavarësisë së Kosovës, por shpejt pas kësaj, filloi të ketë rënie përsëri.
58. Një çështje e rëndësishme është ofrimi i zgjidhjes për të zhvendosurit në komunën e Mitrovicës, duke pasur parasysh numrin e madh të të zhvendosurve nga kjo komunë. Duhet të zhvillohen programe specifike për këtë komunë, në mënyrë që të forcohen marrëdhëniet ndëretnike dhe po ashtu të krijohen mundësi më të mira jetese.
59. Në dialogun Kosovë-Serbi, gjithashtu duhet të përfshihet diskutimi i kthimit të të zhvendosurve nga Lugina e Preshevës në Kosovë apo kudo tjetër. Ngjashëm, të kthyerve në Luginën e Preshevës duhet t'u ofrohet siguri, kushte më të mira jetese dhe mundësi punësimi. Kthimi i të zhvendosurve në komunën e Mitrovicës dhe në Luginën e Preshevës duhet të jetë pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjore midis Kosovës dhe Serbisë.
60. Siç është argumentuar në punim, një shumë e madhe fondesh janë dedikuar për çështjen e personave të zhvendosur. Gjithsesi, është pranuar se ende nuk janë të mjaftueshme për të rritur numrin e të kthyerve në të njëjtën proporcion me shumën e fondeve. Në këtë kontekst, duhet të ketë më shumë fonde të alokuara për kthim nga donatorët ndërkombëtarë dhe Bashkimi Evropian, së bashku me ekspertizën e tyre dhe shkëmbimin e përvojave.
61. Siç u argumentua në punim, shumica e fondeve janë alokuar për të ndërtuar dhe ri-ndërtuar shtëpitë e të zhvendosurve. Kurse, projektet e kushteve të banimit duhet të fokusohen veçanërisht në veri të Mitrovicës ku një numër i madh i shtëpive janë uzurpuar. Në vende të tjera duhet të ketë më shumë projekte për të përmirësuar shkathtësitë e punësimit përmes trajnimeve në klasë dhe në punë, rritjen e numrit granteve të vetëpunësimit dhe gjithashtu përfshirjen e komuniteteve në iniciativat për firmat fillestare.

- 62.** Duke pasur parasysh rritjen e ngadalshme ekonomike në Kosovë, këto projekte do të rrisin mundësinë e kthimit të qëndrueshëm; domethënë do të sigurojnë integrimin ekonomik të komuniteteve dhe do të rrisin probabilitetin e tyre për gjenerimin e vazhdueshëm të të ardhurave, ashtu që të mos bëhen barrë për sistemin e mirëqenies sociale.
- 63.** Duke ditur nivelin e lartë të analfabetizmit tek komunitetit RAE, një rekomandim i rëndësishëm në lidhje me financimin, do të ishte rritja e fondeve nga BE. Kjo do të përmirësonte qasjen në arsim dhe përfshirjen sociale të të kthyerve të këtij komuniteti.

